



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

### PROCESVERBAL

**Mbajtur më 08 qershor 2023**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës dhe anëtarët e KKSBB-së: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Shekfi Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtësor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit–Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike–Kërpimeh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtësor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: znj.Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian dhe z.Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së (në zëvendësim të z. Edolind Vishaj), z. Bekim Karagjia – OSCE dhe përkthyesi i KFOR-it z. Asdren Llugolli.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, të respektuar anëtarë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të hapi mbledhjen e KKSBB-së.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

### Rendi i Ditës

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi a ka dikush diçka rreth pikave të rendit të ditës.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, duke pas parasysh se ne kemi një plan pune dhe është e nevojshme të diskutojmë për implementimin e planit të punës, propozojë të përfshihet në cilën do pikë që kemi mundësi për ta diskutuar.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, çështjen e cekur nga parafolësi propozoj që ta diskutojmë në pikën të ndryshme.

*Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me plotësimin që plani i punës së KKSBB-së të diskutohet në pikën e rendit të ditës të ndryshme.*

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më**

**27 mars 2023**

*U miratua njëzëri*

**2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** fillimisht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari.

**z. Nijazi Jashari,** theksoi, në pika të shkurtra po paraqes Raportin e Policisë së Kosovës, pasi që ky veç se është dhënë për periudhën janar deri më 31 maj 2023. Situata e përgjithshme e sigurisë në zonën e përgjegjësisë të Stacionit Policor Podujevë vazhdon të mbetet e qetë dhe nën kontroll. Zhvillimet politike t gjatë kësaj periudhe në Republikën e Kosovës nuk kanë ndikuar në situatën e sigurisë. Niveli i veprave penale nga krimet e rënda dhe krimit të organizuar mbeten në nivel të ulët pa ndikim në përkeqësim të situatën e sigurisë. Pra nuk ka pas ndonjë ngjarje politike që do të ndikonte në parametrat e sigurisë publike. Tensionet ndëretnike janë në nivel të dukur; Tensione religioze ka brenda llojit, ndërsa jo jashtë llojit; Tensione sociale nuk ka. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar vepra penale të rrezikshmërisë më të ulët të cilat nuk kanë pas ndikim në situatën e përgjithshme të sigurisë. Në pjesën kufitare nuk kemi pas raste të raportuara, sikurse e dini kemi perimetrin atë e kemi nën kontroll. Në pika të shkurtra do ju njoftoj për disa prej aktiviteteve më të rëndësishme dhe për veprat e raportuara. Gjatë kësaj periudhe kemi pas 13 raste të raportuara të posedimit të paautorizuar të substancave narkotike, psikotrope dhe analoge dhe një prej rasteve që vlen të theksohet e që është përmendur edhe në mbledhjen e kaluar ka qenë në fshatin Gllamnik me një sasi më të madhe.

Një rast i vrasjes ka ndodhur në fshatin Dumnicë dhe personat e dyshimtë janë të arrestuar; Tri raste kemi pas të hetim vdekjes; Një rast vrasje në tentativë; Dy raste të vrasjes së rëndë në tentativë, ku njëri ka ndodhë në fshatin Siboc dhe rasti tjetër para një një javë rrugës për në fshatin Dumnicë, me ç'rast kryesor i kësaj vepre është arrestuar dhe arma është konfiskuar. Nga kjo ngjarje një person është i plagosur; Nga rastet e dhunës në familje janë raportuar 28 raste, prej tyre 11 raste i kemi me urdhër mbrojtës me të cilat merret Policia e cila në vazhdimësi bënë monitorimin e tyre; Raste të hapura kanë qenë 315; Raste të aksidenteve në trafik me dëme materiale dhe lëndime kanë qenë 142; Raste të zbuluara 97; Janë shqiptuar 3545 tiketa për kundërvajtjet në komunikacion; Raste të armëve të konfiskuara janë 20; Raste të arrestimeve-23 persona; Lokale të kontrolluara-17; Aksidente në rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë 3 raste; Vetëm në muajin maj për tejkalimin e shpejtësisë në rrugën magjistrale janë shqiptuar 571 tiketa dhe për këto pak ditë të muajit qershor i kemi 70 tiketa të shqiptuara.

Komandanti në vazhdim foli edhe për gjendjen në Stacionin policor sa i përket resurseve njerëzore. Nënvizoi, staf civil-10 zyrtar, të liruar nga bartja e uniformës për shkak të problemeve shëndetësore-10 zyrtarë. Në këtë interval kohorë kemi një dorëheqje të zyrtarit policor, ndërsa në procedurë të dorëheqjes është edhe një tjetër zyrtar, në transferim të përhershëm - 3 zyrtar, në transferim të përkohshëm - 4 zyrtar policor,

3 zyrtar policor në këtë interval kohor kanë shkuar jashtë shtetit dhe nuk jemi në dijeni se a do të kthehen apo jo, ndërsa në pension kanë shkuar 3 zyrtar policor. Sikurse jeni në dijeni për ngjarjet që janë duke ndodhë në Mitrovicë, orari ka qenë 12 orësh, disa kanë kaluar në orar të rregullt, ndërsa disa ende janë duke vazhduar me orar të stërvjatur. Gjatë ditës ndodhë që së paku njëherë, e kemi raste edhe nga dy herë që sipas kërkuesave dërgojmë staf policor në Mitrovicë, varësisht prej zhvillimeve. Në ora 4 të mëngjesit duhet ti dërgojmë 5 zyrtar dhe 5 të tjera i kemi në gjendje gatishmërie, të cilët punojnë me orar 12 orësh. Këto janë të dhëna në pika të shkurtra. Ka edhe probleme dhe telashë ku jemi të vetëdijshëm por analiza jonë e krimeve tregon se më pak vepra penale asnjëherë nuk kemi pas, statistikat i kemi mjaft të mira, brenda 5 muajve i kemi diku 400-450 raste. Te rastet e veprave të vjedhjeve qëndrojmë më mirë se çdo herë, ndërsa te rastet e rënda të veprave penale jemi më mirë sa i përket statistikave. Sfidë vazhdon të jetë trafiku, komunikacioni, aksidentet në trafik në rrugën magjistrale dhe qytet, pastaj bllokimi i trotuareve.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi fjalën e ka znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së.

**z. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së**, theksoi, sa i përket misionit që kemi ekipi ynë vlerëson se situata në Komunën e Podujevës sa i përket sigurisë publike është stabile dhe e qetë. Gjatë gjithë kohës kemi pas takime të vazhdueshme me personel të Shërbimit të Zjarrfikësve ku kemi marrë informata për kapacitetet e tyre dhe aktivitetet që i realizojnë. Po ashtu takime të rregullta kemi pas edhe me Policinë kufitare konform misionit që kemi. E përsëris, sipas vlerësimeve që i kemi vlerësojmë se situata e sigurisë publike në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lidhur me raportimet e paraqitura nga Komandanti i Stacionit të Policisë dhe përfaqësueses së FSK-së, hap diskutimin rreth këtyre informatave.

Unë i falënderoj për informatat e paraqitura, e që janë informata të rëndësishme dhe unë i bashkëngjitim kësaj dhe uroj që gjendja të jetë e qetë dhe sa më pak probleme në fushën e sigurisë. Sikurse e potencoi komandanti ne po mbajmë një bashkëpunim të rregullt dhe siç shihet njëherë përnjëherë jemi një prej komunave të qeta dhe shpresoj se do të vazhdojmë kështu. Me që nuk ka të interesuar rreth kësaj pike kalojmë në pikën e radhës.

### **3.Informatë për aktivitetet e KKSBB-së në vitin 2022**

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, Grupi punues ka përgatitur informatën. z. Shemsi Jashari, në cilësinë e koordinatorit të grupit fillimisht e ka fjalën lidhur me informatën.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, si grup punues kemi pas për detyrë hartimin e Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2023 dhe informatën për punët dhe aktivitetet e KKSBB-së në vitin 2022. Formati i informatës ka vazhduar me qenë i njëjtë sikurse është përgatitur më herët. Besoj se nga ky vit e tutje duhet ndryshua edhe formati i informatës, për të vendosur edhe disa indikatorë ku përfshihet edhe realizimi i planit të punës. Ajo që vlen të theksohet për vitin 2022 është se mbledhja e parë është mbajtur me datë 08 qershor 2022 dhe grupi punues është themeluar bukur vonë. Informata krejt çka përfshinë dhe çka është bërë prej KKSBB-së është një pjesë e planit të punës që ka qenë i miratuar, kur them një pjesë nënkuption se nuk ka pas një aktivitet të KKSBB-së që është zhvilluar. Jemi në dijeni se sipas udhëzimit Administrativ përkatës gjatë vitit duhet mbajtur së paku 6 mbledhje. Me një fjalë në informatë është pëershruar një përmbledhje e përmbytjes së procesverbaleve. Mendoj se këtë vit grupi punues duhet të themelohet më herët për të përgatitur Planin e

punës së KKSBB-së me kohë, për të filluar vitin me plan të aprovuar. Kjo ishte në pikë të shkurtra rreth përgatitjes së Informatës.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lidhur me informatën në fjalë ka dikush ndonjë sugjerim apo ka diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e vë në votim.

*Konstatim:*

*Informata për punët dhe aktivitete e KKSBB-së për vitin 2022 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedoheret në Kuvendin e komunës.*

#### 4.Informatë për sigurinë në shkolla

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Fetahu

**z. Avni Fetahu**, theksoi, Drejtoria e Arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithë përfshirje dhe llogaridhënie, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Në funksion të kësaj, DA do të sigurojë infrastrukturë shkolllore moderne, mjedis të sigurt, të qetë dhe miqësor, kuadër profesional dhe kompetent për një mësimdhënie cilësore, që do të ju mundësojë të gjithë nxënësve zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre, në pajtim me aftësitetë psikike e fizike të tyre dhe me kërkkesat e shoqërisë.

Shikuar në përgjithësi, dhe duke u bazuar në raportet e policisë dhe raportet e Drejtorëve të shkollave, si dhe raportet e DA, në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor në këtë periudhë shkolllore 6 mujore gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt.

Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Podujevës si dhe raportet e drejtorëve të shkollave. Në kuadër të këtij 6 mujori kemi pas mbledhjen e drejtorëve të shkollave ku u diskutua Për sigurinë në shkolla – masat për parandalimin e dhunës në shkolla në koordinim gjithherë me Policinë e Kosovës; Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla, ku vlen të theksohet se në Udhëzimin Administrativ të fundit për Fuqizimin dhe funksionalizimin e plotë të organeve qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollave jemi komuna e parë që kemi themeluar organet që i parashev Udhëzimi Administrativ. Vlen të theksohet se është me një vullnet të Kryetarit të Komunës edhe zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik në shkolla, pa dashur të kthehem i në të kaluarën ku kemi pas vetëm tre psikolog në shkolla, ndërsa sot i kemi dhjetë psikolog, kemi pas 1 pedagog sot kemi 3 pedagog, kemi pas 4 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta, ndërsa sot 13 me nevoja të veçanta.

Sigurimi i transportit të nxënësve si masë sigurie , aty ku janë mbi 4 km largësi është i organizuar nga Komuna si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, që i vijojnë mësimet në klasat përfëmijët me nevojat e veçanta, në shfmu “Kongresi i Manastirit” në Gllamnik.

Te ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkolllore jemi fokusuar aty ku kemi pas mundësi edhe te Rregullimi i rrrethojave të oborreve të shkollave. Gjithashtu jemi fokusuar edhe për ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve përkëmbësor.

Bashkëpunimi i DA-së me Policinë e Kosovës ka qenë në nivelin e duhur përsigurimin dhe garantimin e një mjedisi të qetë, e që ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe më tutje. Në kuadër të krijimit të sigurisë ne jemi fokusuar edhe me instalimin e kamerave të sigurisë në çdo shkollë dhe mirëmbajtjen e tyre. Si DA jemi ballafaquar edhe me sfida. Përkundër vlerësimeve të gjendjes së sigurisë së përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës si të qetë, të sigurt dhe stabile, megjithatë kemi çështje, fatmirësish jo të shumta, të cilave ende nuk kemi mundur t'u japim zgjidhje të plotë. Disa nga to janë: Incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve, lokalet afër shkollave, qentë endacak, komunikacioni,

DA në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në koordinim me Policinë e Kosovës, drejtoreti e shkollave, organet e shkollave, QPS, OJQ etj. do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mjeshtërisht që dëshironi që të sigurt në të gjitha institucionet edukative-arsimore.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, e hap diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, kam një pyetje, shkollat tonë a janë të pajisura me sistem përfikjen e zjarrit dhe a mirëmbahen aparatet përfikjen e zjarrit si dhe a kemi kontratë përkëtë, çështja tjetër ka të bëjë me transportin e fëmijëve që po bëhet, sepse unë kam rastisë disa herë, po e theksoj te shkolla në fshatin Glamnik ku u përmend, që në një kombibus kanë qenë aq shumë nxënës sa që vozitësi ka pas vështirësi të lëviz timonin. Është mirë që të sigurohet transporti por siç duket vijat nuk po mjaftojnë, automjetet që janë angazhuar për të bërë transportin ose kanë nxënës më shumë ose eshtë pa përgjegjësi e operatorëve ekonomik që në vend që bëjnë transportin me dy herë e bëjnë përnjëherë. Pra një kombibus me 12-13 ulëse e me bartë 20 nxënës kjo nuk eshtë në rregull dhe mendoj se kjo çështje meriton një trajtim të veçantë. Te shkollat, përfshirë edhe këto që po ndërtohen a janë të planifikuar shkallët emergjente, a ka plan të evakuimit nëpër objektet publike, specifikisht në shkolla dhe stafi mësimdhënës dhe nxënësit që eshtë dashur të njoftohen se nëse ndodhë diçka cila eshtë rruga për braktisje të shkollës sa më shpejtë. Nxënësit duke përfshirë edhe Këshillin e prindërve të jenë të njoftuar se çka duhet bërë në rast se ndodh diçka. Nëse nuk ke përgjigje, megjithëse më kërkohet nga terreni të kërkoj përgjigje mjafton që të bëhet në mbledhjen tjetër për ti përbledhur si informatë por nëse ke përgjigje tash eshtë edhe më mirë.

**z. Avni Fetahu**, sa i përket sistemit përfikjen e zjarrit ju njoftoj se eshtë një kontratë e veçantë që përfshinë institucionet e Komunës së Podujevës si Administratën, Arsimin dhe Shëndetësinë, ka një menaxher të kësaj kontrate, dhe bëhet kontrollimi i aparateve të zjarr fikjes dhe mbushja e tyre, si dhe ndërrimin e atyre ku eshtë e nevojshme. Çdo objekt institucional ka pajisjen e zjarrit. Te transporti dua të ju njoftoj me plotë përgjegjësi se sipas kontratës që e kemi nuk ka mbingarkesë me rastin e transportimit të nxënësve. Ndërsa se a ka mbingarkesë të nxënësve me rastin e transportimit te operatorët privat të cilët e kanë koordinimin me prindëri, përgjigja eshtë se po. Më vjen keq se pas një periudhe kaq të gjatë ka dalë inspeksioni dhe ka ndërmarrë masa dhe kanë shqiptuar gjoba lidhur me këtë çështje. Kjo formë e transportimit të nxënësve nuk eshtë në rregull dhe sigurisht duhet të mbikëqyret në mënyrë sistematike nga autoriteti kompetent komunal.

Sa i përket planit të evakuimit, sigurisht që në diskutimet me Komandantin e Stacionit policor, nisur nga një përvojë e mirë e tyre por edhe të juaj eshtë mirë që këtë çështje ta hapim së bashku me Drejtoren të shkollave edhe t'i pasurojmë ato plane. Përndryshe në objektet shkollore të reja janë të parapara planet e evakuimit të nxënësve dhe personelit mësimor në rast se paraqitet nevoja.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, falënderojmë Drejtoren përsqarimet, a ka dikush diçka tjetër për të shtuar. Nënvizoi, ajo që u theksua mendoj se eshtë mirë të bëhet nga Drejtoria e Arsimit sa i përket planit të evakuimit. Janë bërë disa biseda lidhur me këtë edhe me FSK-në dhe do të ishte mirë të involvohet edhe FSK-ja duke marrë përbazë edhe përvojën që kanë në këtë aspekt. Do të ishte mirë për të bërë edhe një lloj trajnimi nëpër shkolla por njëkohësisht edhe në hartimin e planeve të evakuimit aty ku mungojnë. Sa i përket transportit të fëmijëve nëpër shkolla eshtë një çështje të cilën e kam ngritur edhe më herët në Drejtoren e Arsimit. Unë kam pas 2-3 intervenime drejtpërsëdrejti sepse kam hasë në numrin e madh të fëmijëve në automjet. Kam kërkuar nga shërbimet përkatëse, përfshirë edhe zyrtarët e arsimit me u marrë me këtë çështje, këtu do të aktivizohet edhe inspeksioni, inspektorët e komunikacionit, por njëkohësisht edhe Policia e Kosovës që në rastet kur hasin situata të tillë duhet të ndalojen dhe gjobiten. Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar, kalojmë në pikën e radhës.

## **5. Të ndryshme**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, mbet që në kuadër të kësaj pike të diskutohet çështja e realizimit të Planit të punës së KKSBS-së. Ne para jush e kemi një kalendar të aktiviteteve të rregullta të cilat duhet të realizohen nga KKSBS.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi nëse i referohemi procesverbaleve vitin e kaluar por edhe takimeve që kemi pas deri tash vazhdimisht për tu bërë publike dhe për tu diskutuar ka qenë çështja e Planit të reagimit emergjent. Vazhdimisht është thënë ka një Plan megjithëse pak i vjetër e që është dashur me përditësuar. Me akterët implementues që janë pjesë në rast se aktivizohet Plani i reagimit emergjent, kemi diskutuar dhe asnjeri prej tyre nuk ka njohuri se ekziston një plan i tillë. Muajin e kaluar kam bërë një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare për të pasur atë plan pasi që ndryshe nuk na është ofrua dhe si rrjedhojë tri javë na është vonuar përgjigja gjë që bie në kundërshtim e Ligjin për Qasje në doc Zyrtare. Në këtë aspekt jam detyruar t'i drejtohem Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe për mes saj të kërkoj atë dokument. Nga autoriteti komunal është kthyer një përgjigje me një draft dokument në formatin Word që gjithçka mundet me qenë veç plan i reagimit emergjent jo. Ku kemi diskutuar në takime por edhe pas takimeve kemi thënë që nëse nuk ka plan e që në fakt s'ka plan, atëherë ulemi dhe shqyrtojmë mundësitë e përgatitjes. Nuk është keq nëse nuk ka plan por është keq nëse e mohon që s'ka dhe nuk bën asgjë për ta përgatitur atë. Një pasivitet i Drejtorit të DSHPMSH që sot po mungon është vërejtur në tërë takimet. Drejtori në fjalë nuk po gjen kohë të marr pjesë në takime, as të angazhohet rreth hartimit të planit, as në realizimin e aktiviteteve sipas planit të punës së KKSBS-së. Mund të jetë i ngarkuar dhe nuk dua të paragjykoj, por nëse nuk mund të kryej punën që e ka marrë përsipër atëherë të lëshojë rrugë. Dmth informatën për qasje në doc. zyrtare më ashtë dashur ta siguroj përmes Agjencisë për Informim dhe Privatësi me të cilën ke qenë edhe ti në komunikim e që nuk është dashur, sepse si anëtar i KKSBS-së ndoshta kam pak të drejtë më të drejtpërdrejtë për të pasur qasje në atë dokument, por sido që të jetë ajo që është e rendësishme për mua është që përgjigja e Komunës e konfirmon që nuk ka plan të reagimit emergjent. Ligji obligon për të pasur plan, siguria kërkon për të pasur plan. Ajo që propozoj është që Komuna, në këtë rast ju Kryetar si përgjegjës që jeni për të shikuar mundësitë për të themeluar një grup përfillimin e hartimit të planit emergjent, e që KKSBS mund të jetë si ndihmesë, sepse aty kërkohet ekspertizë dhe të dhëna të shumta prej Drejtorive, kështu që me filluar me hartimin e Planit të reagimit emergjent përfillimisht se Komuna e Podujevës ka një dokument, një udhëzues që në rast nevoje për qasje të problemit. Qëllimi është që takimet e KKSBS-së të mos shndërrrohen vetëm si takime ku na informon Policia dhe KFOR-i. Unë kam pasur një takim me përfaqësuesin e KFOR-it që është pjesë e këtij Këshilli, dhe është diskutuar kjo temë e Planit te reagimit emergjent si dhe ka shprehë gatishmërinë me ekspertizën prej KFOR-it përfillimisht se nuk është dashur e këtij plani. Po besoj se edhe FSK me kapacitetet e veta është e gatshme të jap kontributin e vet në hartimin e një plani i cili kishte përfillimisht se Komuna e Podujevës ka një udhëzues që do të dilte prej atij grupei punues. Është edhe më herët një informatë se asnjë plan, asnjë aktivitet i planifikuar prej KKSBS-së nuk është bërë dhe e njëjtë ka ndodhë edhe deri tash, përvëç informatave të cilat i kanë dhënë organet e sigurisë. E kemi në plan përmes prill dhe maj vlerësimin e mjedisit publik nga aspekti i sigurisë që është menduar përfillimisht se nuk është dashur e këtij plani. E kemi një plan përmes prill dhe maj vlerësimin e mjedisit publik nga aspekti i sigurisë që është menduar përfillimisht se nuk është dashur e këtij plani.

qëllim të identifikimit të projekteve kyçë ku janë, mirëpo nuk u mbajte nuk ka pas asnjë aktivitet në këtë punë. Është tash aktiviteti i dytë hartimi i listës së prioriteteve për investime dhe adresimin në projekt buxhetin komunal 2024 që është i planifikuar mes qershorit dhe korrikut e që është menduar atëherë se para se të aprovohet buxheti komunal për t'i adresua ato çështje që lidhen me aspektin e sigurisë. Unë po kërkoj që këto aktivitete që i kemi bërë ti mbajmë sepse nuk janë të rënda për tu organizuar një punëtori, me i thirre akterët si profesionistë të fushës, në këtë rast për t'i trajtuar këto tema dhe me dal me rekomandime, me qellim për t'ju shërbyer edhe juve gjatë punës ditore që e bëni.

Ajo çka mendoj se është prioritet mbi prioritete është hartimi i këtij plani e që kish për ti paraprirë themelimi i një grupei punues, në këtë kontekst për angazhuar edhe ekspertizë që Komuna e ka atë mundësi, për të kontraktuar dikë që mund ta bëjë këtë punë dhe ne për të ofruar ndihmë qoftë përmes kapaciteteve të brendshme nëse ka Komuna, pra me themeluar grupin që e punon vet planin. Një shembull si referencë që mund të na shërbejë shumë është Komuna e Kaqanikut, sepse dokumentin e ka të publikuar në ueb faqe zyrtare të saj. Pra ai dokument mund të merret si referencë edhe mund të ndihmojë shumë në punën e grupit punues.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, z. Jashari ju falënderoj për këto këshilla. Sa i përket kërkesës së Juaj për qasje në dokumente publike, unë mendoj se shërbimi u ka ofruar atë doc apo draft të cilin e kanë pas në dispozicion, e që realisht po rezulton se nuk kanë pas doc. Pajtoj plotësisht se Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrotjtjes dhe Shpëtimit përveç punëve dhe detyrave që ka duhet të merret edhe me punë të tjera dhe besoj se tash e tutje do të kenë parasysh këtë çështje. Është shumë e rëndësishme me përgatit planin e reagimit emergjent. Meqë e paska përgatitur Planin Komuna e Kaqanikut besoj se është një model i mirë. Të shohim cilët do të ishin akterët dhe të cilave fusha që do të merreshin me përgatitjen e planit, në mënyrë që unë ta themelojë grupin punues i cili do të vazhdoj punën me hartimin e planit. Duhet të involvojmë kuadro të ndryshme duke siguruar të dhëna të nevojshme për grupin për të përgatitur dokumentin dhe ta përgatisim sa më shpejtë që është e mundshme. Sa i përket aktiviteteve tash jemi në muajin qershor dhe siç shihet përveç planit vjetor, informatave për punët dhe aktivitetet e KKSB-së dhe kjo informata për Planin e reagimit emergjent, s'paskemi pas çfarë tjetër të japim, përndryshe drejtori duhet të jetë në dijeni dhe nëse ka ndonjë çështje duhet të më informoj dhe duhet ta inicioj problemen, por nga ajo që shihet po rezulton se ai nuk ka pas qa të dërgojë sepse vetëm u fillua si draft i planit emergjent dhe ka mbete në atë gjendje pa u përfundua dhe unë për këtë nuk kam qenë në dijeni. Mirëpo ne e kemi për detyrë ta përgatisim dhe besoj se mund ta bëjmë këtë. Drejtori do ta merr përsipër punën lidhur me përgatitjen e Planit, duke iu referuar edhe procedurave tenderuese, po ashtu të merret si model edhe Plani i Komunës së Kaqanikut. Sigurisht do të ndahet një shumë e mjeteve me qëllim që të përgatitet si duhet.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, ajo që ne e kemi parë në planin e investimeve kapitale Komuna e Podujevës ka nisur një varg projektesh, çka nënkupton se duhet të reflektoj pjesa e atij plani emergjent. Kushdo që merr përsipër përgatitjen e atij dokumenti duhet të jetë familjarizuar me projektet që do të realizohen, të paktën katër vjeteshin e parë, për tu siguruar që ato objekte, qasja në to dhe trajtimi i tyre duhet të bëhet përmes planit të reagimit emergjent.

**z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ajo që është e rëndësishme është fakti se ka filluar të punohet në Podujevë. Janë disa objekte të mëdha të cilat duhet të suporohen në Planin e reagimit emergjent. Puna e Planit është mirë që është ngritur si

problem sepse është aktualizuar si çështje që duhet kryer. Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit prej këtij momenti i jap detyrë për tu marrë me këtë çështje.

**z. Nuhi Selimi**, theksoi, ka rrëth 4 muaj ka qenë një trajnim organizuar nga OSBE ku kanë marrë pjesë, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Shërbimi i zjarrfikësve dhe është dhënë shumë qartë skema si formohet ky Plan për çështje të emergjencave. Pra kanë qenë pjesëmarrëse këto tri Drejtori. Përgatitjen e këtij dokumenti nuk e pashë si çështje problematike duke marrë përbazë referencat të cilat u theksuan gjatë procesit të trajnimit.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, thash mora informatë se në atë trajnim ishin prezantë përfaqësues të tri Drejtorive dhe është mirë kjo pasi që kanë edhe njohuri si ti qasen kësaj çështjeje. Nëse jemi gjithçka në rregull ne do të fillojmë procedurat me qellim të përgatitjes së Draft Planit emergjent.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, sa i përket Planit të Reagimit unë pajtoj se ka shumë nevojë ta ketë Komuna, por jo vetëm kjo por të gjitha komunat në nivel vendi kanë nevojë ta kenë planin për reagim të emergjencave. Unë kam pas konsultime të vazhdueshme me AME për menaxhim të emergjencave dhe në koordinim dhe bashkëpunim me ta i kemi filluar hapat për të implementua një draft plan të emergjencave. AME e kanë marrë si obligim dhe përgjegjësi që të merren me këtë çështje. Kjo është edhe arsyja që dy herë kanë qenë në trajnim zyrtarët për emergjencat, KLSB-të por edhe zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike por edhe të Drejtorive tjera të cilët kanë të bëjnë me mjedisin dhe me fushën e emergjencave. Prandaj në koordinim dhe bashkëpunim me ta, e së shpejti është paralajmërua edhe një takim në Komunë ku do ti bisedojmë këto çështje dhe do të nxjerrim përfundimisht një plan. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave-AME është kompetent në nivel vendi dhe ne jemi në koordinim me ta ku do të mbajmë takimin, dua të them se ka iniciativë për përgatitjen e këtij plani, por asnjëherë nuk e përjashtojë mundësinë për angazhimin e një konsulencë të jashtme e cila do të na ndihmonte në këtë organizim, por paraprakisht them tu jepet përgjegjësia atyre që edhe e kanë këtë përgjegjësi, e nëse ata nuk arrijnë së bashku me ne ta përpilojnë këtë plan atëherë pse jo të shpallim dhe angazhojmë një konsulencë nga jashtë. Si rezultat i vërvshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën tonë ata e kanë marr me prioritet që ta përpilojmë një plan sa më shpejtë. Unë do të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin me AME dhe në kohën e duhur do të jeni të njoftuar dhe ftuar edhe ju që bashkërisht ta përfundojmë këtë plan.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, pas këtij diskutimi mua më gjzon fakti se ne kemi kapacitete për ta përgatitur këtë plan dhe prej këtij takimi po dalim me një konluzë që brenda 30 dite të bëni draftimin e parë të këtij plani dhe më njoftoni mua, e pastaj unë e njoftoj KKSBB-në. Në këtë punë përfshini të gjithë akterët dhe kapacitetet e nevojshme për punën e juaj.

Ndër tjera shtoi, edhe ky kalendari i aktiviteteve që e ka hartuar grupi punues, mendoj që për të gjitha këto aktivitete, për ndonjë takim apo work shop që është e nevojshme të mbahet është mirë ta marr përsipër ky grup punues. Ne kemi gatishmëri për ofrimin e ndihmës si institucion, por iniciativat, organizimet t'i marrë ky grup punues që ka hartuar planin e punës së KKSBB-së.

**z. Shemsi Jashi**, theksoi, sa jam në dijeni në një takim të KKSBB-së është caktuar një koordinator i KKSBB-së, që nënkupton që duhet t'i koordinojë këto aktivitete. Koordinatori jo patjetër duhet t' i kryer punët dhe aktivitete vet.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, sikurse e shoh, koordinator i këtij Grupi punues qenka z.Shemsi Jashari. Pra a mund ta japim si detyrë e aq ma tepër kur jeni edhe përfaqësues i shoqërisë civile dhe kemi besim të plotë te ti në organizimin dhe kryerjen e këtyre aktiviteteve sipas Planit të punës. Nga ne ke mbështetjen e plotë andaj merrni rolin e një grupei këshill dhënës për mua. Por mos të merret që Kryetari i Komunës të merret me këtë work shop të juaj.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, çka unë mendoj KKSB ka një sekretariat dhe në aspektin teknik administrativ të kryej punën, t'i bëjë ftesat, të caktojë lokacionin e mbajtjes së takimit si dhe për koston nëse takimi fjala vjen mbahet jashtë objektit të Komunës. Përndryshe nuk është ndonjë problem për të marrë iniciativë. Përveç kësaj Drejtoritë që janë këtu duhet të përgjigjen për atë punë, nuk mundemi të detyrojmë një drejtor të marr pjesë apo për të kërkua për të na dërguar një përfaqësues.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, sa i përket angazhimit të Drejtorëve në aktivitete unë do të kujdesem për këtë sa i përket çështjes së komunikimit, ftesave këta do ta marrin përsipër, ju vetëm më tregoni se çka kërkohet nga ana ime, nga ana tjetër mbetet që ju të merreni me punët dhe aktivitet që i merrni përsipër, me rëndësi është që iniciativat të janë të juaja, ndërsa përkrahjen do ta keni nga unë. Në këtë aspekt edhe mundësia për të kritikuar kufizohet, sepse jeni vet mbrapa këtyre punëve dhe aktiviteteve.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, sa i përket punës së KKSB-së unë jam pjesë e kësaj, dua të jap kontributin. I kuptoj vështirësitë, kufizimet dhe mangësitë në të kaluarën, por nëse ka qasje refuzuese dhe injoruese ndaj diçkaje që është obligim apo mandat i joni nuk duhet lejuar. Ajo që kam kërkuar nga takimi paraprak që ju keni dalë më herët për shkak të angazhimeve ishte që të transmetoheshin këto takime, pasi që sistemi i kamerave është dhe pse mos të transmetoheshin online. Në takimin e kaluar është diskutuar që KLSB-të kanë vështirësi të mblidhen për shkak të mungesës së interesimit dhe në këtë rast mendoj se Komandanti i Stacionit do të mund të na ndihmonte, këtu ka polic, po ashtu pjesëtarë të FSK-së që janë me pension, mjaftron një qasje për të diskutuar me ta dhe ekspertiza e tyre në fushën e sigurisë nuk përfundon me dalje në pension, e kemi një aset të paangazhuar dhe mendoj se ata do të ndiheshin mirë nëse angazhohen dhe dhënë një kontribut për komunitetin, por mjaftron për të ditur se cilët janë dhe për të diskutuar me ta. Çështja e kompensimit nuk jam në dijeni se qysh është e rregulluar për nënkomitete por patën apo jo kompensim unë nuk besoj se një ish polic që me 65 vjet ka dalë prej shërbimit do ta merrte me pritëse që njëherë në muaj të shkoj në takimin e Këshillit për të ofruar përvojën e vet e që do të kishte me shërbje shumë në këto nënkomitete. Ndoshta lista e policëve të pensionuar do të mund të na sigurohej, e njëjtë situatë vlen edhe për FSK-në, për t'i kontaktuar ata persona, sepse mendoj se do të ndiheshin mirë nëse angazhohen dhe do ti plotësonin këto nënkomitete që janë në teren.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, dua të marr një konfirmim nga Komandanti i Policisë se informatat e dhëna a paraqesin problem nëse bëhen publike përmes transmetimit online, sepse për ti transmetuar nuk e kemi problem. z. Shemsi Jashari ju mund të bëni kërkësë zyrtare për transmetim, ndërsa ne për çështjet që nuk janë për transmetim kufizohemi në këtë aspekt. Mua nga Komandani i Policisë më vjen një raport favor por se a bëhet publik apo jo nuk jam në dijeni.

**z. Nijazi Jashari**, theksoi, disa statistika nga puna dhe aktivitetet e Policisë dalin dhe bëhen publike, por diskutimet për disa tema dhe çështje tjera kjo është diçka tjetër.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, zyrtari për punë administrative të KKSB-së thekson se informatat për shkak të çështjes së sigurisë nuk është mirë të dalin në opinion.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, aspekti i sigurisë, ajo që po diskutohet këtu, e kemi përmes raportimeve, këtu po jepen statistika dhe nuk janë duke u përmendur emra edhe nuk mund të përmenden se ka të bëjë me privatësi. Gjëra sekrete në këtë Këshill nuk flasim. Nëse ndonjëherë ka diçka të tillë unë kisha rekomanduar Komandantin me diskutuar me Ju z. Kryetar në zyre dhe jo në këtë format për shkak se edhe ky është publik, nëse dikush mendon se me njëzet vetë në takim ka diçka sekrete s'është në rregull. Pse mendoj se takimi duhet të transmetohet është për rolin e Këshillit edhe neve që dikush na ka përcjellë duhet ta dijë se a jemi duke e kryer mandatin apo jo, përfaqësimin e tyre dhe e dyta se përveç funksionit të transparencës dikush do të kishte mësuar prej kësaj pune. Nëse ka ndonjë referencë ligjore që e ndalon do të ishte mirë të tregohet, përndryshe për aq sa unë jam në dijeni nuk ka kurrfarë pengese.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi z. Jashari kërkesën në fjalë paraqiteni në formë të shkruar në shërbimin përkatës të Komunës dhe do të kthehet përgjigja konform rregullativës ligjore. Ndër tjera nënvizoi, mendoj që përvojat e mira dhe bashkëpunimi i mirë është mirë të shtyhet përpara, sepse ne jemi institucione publike dhe secili nga ne bëjmë përpjekje në segmente të caktuara, ngase punët dhe problemet tona janë të përbashkëta dhe kemi bashkëpunim të mirë.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi në momentet kur reagon policia bëhet vënë, te masat parandaluese mendoj se Kryetari ka tërë mekanizmat për t'i vu në funksion me qëllim të parandalimit. Kur flasim për problemet rrith shkollave Policia këtu nuk mund e rregullon, këtu duhet të veproj Drejtoria e Arsimit, ose në aspektin e emergjencave.

**z. Nijazi Jashari**, theksoi, konsideroj se Komandanti i stacionit të Policisë dhe Kryetari i Komunës duhet patjetër të bashkëpunojnë ngushtë, përndryshe dështimet janë evidente.

**z. Shemsi Jashari**, në takimin e fundit të Grupit punues për hartimin e planit të punës së KKSB-së, njëri nga pjesëmarrësit ka hap çështjen e pagesave/mëditjeve rrith pjesëmarrjes në takime. Zyra ligjore është dashur të sçarojë këtë çështje dhe të njoftojë anëtarët se kujt i takon pagesa e mëditjeve dhe kujt nuk i takon dhe pse nuk i takon.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lidhur me kërkesën e parafolësit nga zyra ligjore konfirmuan se Njësia e Burimeve Njerëzore është në kontakt me Nivelin qendror sa i përket sqarimeve rrith pagesave. Në momentin që do të bëhen sqarimet në një takim të radhës besoj se do të jepen informata e nevojshme.

Kryetari përmbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarje dhe kontributin e dhënë.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:25**

**Procesverbalin e mbajti**

**Sabedin Namani**

Nr. prot.02-060/04-0039566/23  
Podujevë, datë: 08.06. 2023

